

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Artizanati dhe trashëgimia arumune në Divjakë
ADRESA	https://5pyetjet.al/2026/08/19/artizanati-dhe-trashegimia-arumune-ne-divjake/
BURIMI	5pyetjet.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 05:50:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 gusht 2026, 07:35:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f7c068c5a71f88f64c5f91c72724909a76a95cf5dc333722dce9828efadbffa8
TEKSTI	1c78c21ad78389c137c2d13d4eae3f34173262a6885fe98e7057efb5c9f1131c
PAMJA	b520d12b80d0a07bd68aa52b995a855774272c9ba981ed91e27c82718306d85a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4fbdb6d18d3b8b21cd3e097d39f17474d19ccc66500aec6818f9b6f04f5b331
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	56abbcbaf3b6cd60bdb3dd20a55296f33672a0dccf17da1de9439540995f565
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4fbdb6d18d3b8b21cd3e097d39f17474d19ccc66500aec6818f9b6f04f5b331>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



Hyni
Mirë se vini! Hyni në llogarinë tuaj
 Emri i përdoruesit tuaj
 Fjalëkalimi juaj


[Forgot your password? Get help](#)
Shërim fjalëkalimin
Rikupero fjalëkalimin
 emaili juaj

Një fjalëkalim do t'ju dërgohet në email

SULLIQA

Artizanati dhe trashëgimia arumune në Divjakë

August 19, 2026 0



Kryesoret

[Valuta sot/ Me sa lekë blihet e shitet euro dhe paundi?](#)
September 7, 2026

[Ministria e Financave: Vetëm 23 bashki kanë buxhet kundër zjarrit!](#)
September 7, 2026

[Atentat në Athinë, plagoset 55-vjeçari shqiptar!](#)
September 7, 2026

[Aksident në aksin Levan-Tepelenë, ndërron jetë njëri nga shoferët!](#)
September 7, 2026

Nga Entela Binjaku


Në atmosferën verore të gushtit, në Divjakë, u zhvillua një veprimtari dyditore kushtuar kulturës, traditave dhe trashëgimisë së pakicës arumune. Veprimtaria mbledhi qytetarë dhe përfaqësues të komunitetit të angazhuar në promovimin e diversitetit kulturor dhe në ruajtjen e trashëgimisë së pakicave kombëtare, duke krijuar një hapësirë të veçantë për të vlerësuar punën e palodhur të grave artizane.


Në qendër të veprimtarisë ishte ekspozimi i punimeve artizanale dhe fotografive që pasqyrojnë traditat arumune të ruajtura dhe transmetuara brez pas brezi. Këto punime përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore materiale dhe dëshmojnë për pasurinë e traditave, mjeshtrërinë dhe përkushtimin e grave që kanë kontribuar në ruajtjen e tyre.

Një ekspozitë në nderim të trashëgimisë arumune

Përzgjedhja e datës 15 gusht për hapjen e veprimtarisë kishte një domethënie të veçantë. Kjo ditë përkon me Festën e Shën Mërisë, ose Fjetjen e Hyjllindës Mari, një nga festat e rëndësishme të traditës së komuniteteve të krishtera dhe një ditë me rëndësi të veçantë edhe në traditën arumune.

Për realizimin e ekspozitës, organizatorët kontaktuan pjesëtarë të komunitetit arumun nga Fieri, Berati dhe Lushnja, të cilët iu bashkuan nismës duke sjellë punime artizanale dhe materiale fotografike që dëshmojnë për vazhdimësinë e traditave.





Në kuadër të veprimtarisë u prezantua edhe një koleksion kartolinash me punime artizanale arumune, përmes të cilave u synua dokumentimi dhe promovimi i kësaj trashëgimie. Koleksioni përfshinte:

- Punime me grep me motive gjeometrike;
- Punime me grep me motive lulesh;
- Velenxa të endura në tezgjah;
- Rrugica të endura në tezgjah;
- Fanella të punuara me shtiza;
- Papuçe të punuara me shtiza;
- Çorape të gjata të punuara me shtiza;
- Floktore të endura në tezgjah.

Punimet e ekspozuara nuk përfaqësojnë vetëm një mjeshhtëri artizanale, por edhe një mënyrë të ruajtjes së kujtesës dhe identitetit kulturor. Çdo punim mbart brenda tij elemente të një tradite familjare dhe komunitare, të transmetuar ndër breza.

Veprimtaria u realizua nga Fondacioni “Harriet Martineau”, i cili prej muajit qershor ka nisur zbatimin e projektit në kuadër të mbështetjes së Komitetit për Pakicat Kombëtare, në kuadër të Thirrjes 2026 “Trashëgimia si urë bashkëjetese”.

Thirrja, e hapur nga 26 shkurt deri më 5 maj 2026, mbështet projekte dhe veprimtari që synojnë nxitjen, ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë.

Ndër prioritetet e saj janë:

1. Promovimi i trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare, përmes organizimit të festivaleve dhe aktiviteteve kulturore e ndërkulturore, botimeve dhe kërkimeve shkencore në gjuhët përkatëse, si dhe ekspozitave dhe tryezave të rumbullakëta ndërkulturore.
2. Artizanati, tradita dhe diversiteti kulturor i pakicave kombëtare, përmes ruajtjes dhe dokumentimit të veshjeve tradicionale, si dhe organizimit të panairëve të artizanatit dhe kulinarisë.

Kjo mbështetje bazohet në VKM nr. 769, datë 15.12.2021, për “Kriteret e mbështetjes së nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre dallues kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional e fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e fondit për pakicat kombëtare”.



Veprimtaria në Divjakë është pjesë e punës së vazhdueshme të Fondacionit “Harriet Martineau” për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë arumune. Një vit më parë, Fondacioni realizoi projektin “Trashëgimia dhe kultura arumune, së bashku dhe në një tryezë”, gjithashtu me mbështetjen e Komitetit për Pakicat Kombëtare. Në kuadër të këtij projekti u organizuan tri veprimtari dyditore me titullin “Ekspozitat e shijes”, ku amvisa arumune nga Fieri, Korça dhe Elbasani prezantuan gatime tradicionale të përgatitura prej tyre.

Veprimtaritë u pasuan nga një tryezë diskutimi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Komitetit për Pakicat Kombëtare dhe nga botimi i një broshure kushtuar gatimeve tradicionale arumune.

Këto nisma dëshmojnë se trashëgimia kulturore mund të ruhet dhe të përcillet jo vetëm përmes dokumentimit, por edhe përmes takimeve, ekspozitave dhe shkëmbimit të drejtpërdrejtë ndërmjet brezave dhe komuniteteve.

Projekti do të vijojë edhe gjatë muajit shtator me përfundimin e librit me receta tradicionale arumune të znj. Lefteri Gjoshe, autore e librave për fëmijë kushtuar gatimit, njohëse e kulinarisë arumune dhe fituese e edicionit të dytë të programit televiziv “Gjyshet milionere”, transmetuar nga RTSH.

Ruajtja e artizanatit arumun nuk është vetëm ruajtje e objekteve të së kaluarës. Është ruajtje e një kujtese kolektive, e një mënyre jetese dhe e një identiteti kulturor që vazhdon të jetë pjesë e diversitetit të shoqërisë shqiptare.

Artizanati, tradita dhe kujtesa kulturore janë ura që lidhin brezat dhe e bëjnë trashëgiminë të jetojë në të tashmen.

/Spyjet.al

Related



TAGS Artizanati

divjake

Enteta Binjaku

trashëgimia arumune



Më tepër

Divjakë, dita e 30-të e protestës kundër bashkimit me Lushojën

August 29, 2026

-Territorialja!/ 15 ditë protestë. Divjaka refuzon bashkimin me Lushojën!

August 15, 2026

Divjakë/ Shkoi të vriste 50 vjeçarin, arrestohet i riu dhe 5 të tjerë!

August 13, 2026



Lajmet e fundit

SHBA rinis përpjekjet për paqe në Ukrainë, ish-ambasadoret skeptike!

September 7, 2026

Valuta sot/ Me sa lekë bëhet e shitet euro dhe paundi?

September 7, 2026

Tirana dhe Dinamo shënojnë fitore të reja në kampionat!

September 7, 2026

Ministria e Financave: Vetëm 23 bashki kanë buxhet kundër zjarrit!

September 7, 2026

Atentat në Athinë, plagoset 55-vjeçari shqiptar!

September 7, 2026

5 PYETJET

Rreth Nesh

REKLAMQ

RRETH NESH

EVENTE

SHKRUAR PËR NE

IN THE PRESS

Rruga Hoxha Tahsim nr. 62, Tirana Albania

Kategorite më të lexuara

TE REJAT163295

KRYESORE33047